

## VENDIM

Nr. 757, datë 26.10.2016

### **PËR KALIMIN E SPORTELEVE PRITËSE PËR QYTETARËT TË ZYRAVE VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA**

(përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Kalimin e sporteve pritëse për qytetarët të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), sipas kalendarit të bashkërenduar paraprakisht me marrëveshje nga institucionet në këto bashki:

- a) Kavajë;
- b) Fier;
- c) Krujë;
- ç) Gjirokastër;
- d) Shkodër<sup>1</sup>.

2. Në bashkitë e sipërpërmendura, ku sportelet pritëse për qytetarët kalojnë në administrim të ADISA-s, shërbimi i pritjes për qytetarët për aplikimet për shërbimet e ZVRPPP-ve në Kavajë, Fier, Krujë dhe Gjirokastër ofrohet vetëm nga ADISA. Në të njëjtat bashki, por në njësi administrative të ndryshme nga ku shërbimi i pritjes së qytetarëve ofrohet nga ADISA, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mund ta ofrojnë këtë shërbim, përmes hapjes së sporteve pritëse, me qëllim ofrimin e shërbimit sa më afër qytetarëve, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin në fuqi për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

3. Kërkesat nga noterët për aplikim për kryerjen e shërbimeve për noterët në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme do të vazhdojnë të kryhen sipas përcaktimeve të vendimit nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme vendore dhe Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara”.

4. ADISA kryen veprimtarinë e saj në bashkitë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, jashtë ambienteve të ZVRPP-ve në këto bashki, duke hapur sportelet e saj.

5. ADISA ofron shërbimin për pritjen e qytetarëve nëpërmjet punonjësve të saj, dhe jo përmes kalimit të punonjësve të ZVRPP-ve tek ADISA.

6. Shërbimi i pritjes për qytetarët në ZVRPP-të për bashkitë Fier, Kavajë, Krujë dhe Gjirokastër, që kalon në administrim të ADISA-s, është i patjetërsueshëm nga kjo e fundit përmes marrëveshjeve të koncesionit /partneritetit publik privat.

7. Efektet financiare të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i ADISA-s.

8. Tarifat dhe taksat, që do të mbliidhen nga ADISA, të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kalojnë në llogarinë e ZVRPP-ve.

9. Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme lidhin marrëveshje bashkëpunimi, ku detajohen format, procedurat dhe mënyrat e bashkëpunimit për

---

<sup>1</sup> Shtuar me Vendimin Nr. 725, datë 12.12.2018 “Për një shtesë në Vendimin nr. 757, datë 26.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteve pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”.

ofrimin e shërbimit qytetarëve në sportelet që i kalojnë ADISA-s.

10. Vendimi nr. 674, datë 29.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteve pritëse për qytetarët të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në administrim të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si institucione përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**